E hënë, 19 prill 2021

[Paraqitja e parë]

[Seancë e hapur]

[I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

--- Fillon në orën 15.00

GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita, dhe mirë se erdhët të gjithë brenda dhe jashtë sallës së gjyqit.

Zonja sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqitni çështjen.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës. Lënda KSC-BC-2020-04, Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës.

GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja sekretare.

Përpara se t'u kërkoj të pranishmëve në sallë që të prezantohen, iu kujtoj të gjithëve rregullat që duhet të respektohen gjatë gjithë kohës për të siguruar ecurinë e papenguar të kësaj seance.

Ju lutem ndizni mikrofonin përpara se të filloni të flisni dhe fikeni kur të keni përfunduar. Flisni ngadalë dhe qartë duke qenë se kemi përkthim në dhe prej shqipes dhe serbishtes. Prisni pesë sekonda përpara se të më përgjigjeni mua ose ndonjë pale apo pjesëmarrësi për t'iu mundësuar përkthyesve të përfundojnë përkthimin.

Ajo që thuhet në këtë seancë transkriptohet në kohë reale dhe pas seancës transkripti u vihet në dispozicion palëve dhe publikut. Kujtoj gjithashtu palët se një pjesë e informacionit në

1 këtë çështje është objekt i urdhrave për masa mbrojtëse dhe
2 konfidencialitet. Këtu përfshihet informacioni konfidencial që
3 është redaktuar nga Aktakuza e Konfirmuar në lidhje me identitetin
4 e disa personave në lidhje me data, vendndodhje, dhe të dhëna të
5 tjera.
6 Informacioni konfidencial nuk nxirret në seancë të hapur.
7 Nëse ndonjëra nga palët ose një pjesëmarrës duhet të hyjë në
8 seancë private për t'iu referuar një informacioni konfidencial,
9 atëherë duhet t'i paraqesë arsyet për këtë.
10 Tani do t'u kërkoj palëve të prezantohen, duke filluar me
11 Zyrën e Prokurorit të Specializuar.
12 Zonja prokurore urdhëroni.
13 MS. IODICE: [Përkthim] Mirëdita i nderuar Gjykatës. Për
14 Prokurorinë sot, Prokurori i Specializuar Jack Smith;
15 ndihmësjurist Bernhard Kuschnik; administratore e çështjes Angel
16 Langenberg; dhe unë ndihmësprokurore Vega Iodice.
17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.
18 Tani fjalën e ka Mbrojtja.
19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ju faleminderit. Unë jam Jean-Louis
20 Gilissen nga Oda e Avokatëve të Liezhit të Belgjikës, person që e
21 flet frëngjishten dhe besoj që e flas dhe anglishten. Kam nderin
22 që të paraqitem përpara tribunalit tuaj me z. Aouini. Ai është nga
23 Tunizia dhe është anëtar i Odës së Avokatëve të atij vendi. Ju
24 faleminderit.
25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Gilissen.

Për procesverbalin theksoj se në sallë është i pranishëm edhe klienti juaj, z. Shala.

Tani radhën e ka zonja Administratore. Urdhëroni.

ADMINISTRATORJA: [Përkthim] Mirëdita i nderuar Gjykatës. Fidelma Donlon, Administratore.

GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zonja Administratore.

Për procesverbalin, unë jam Nicolas Guillou, Gjykatës i Procedurës Paraprake në këtë çështje.

I akuzuari paraqitet sot për herë të parë para Dhomave të Specializuara pas konfirmimit të aktakuzës kundër tij.

Z. Shala, çohuni në këmbë ju lutem.

Na e thoni emrin dhe mbiemrin.

I AKUZUARI: Pjetër Shala.

GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Data dhe vendi i lindjes?

I AKUZUARI: 17-09-1963, Prizren.

GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Dhe cila është shtetësia, apo shtetësitë nëse ke më shumë tuaja?

I AKUZUARI: Nënshtetas belg.

GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] A ke ndonjë nënshtetësi tjetër përveç asaj belge?

I AKUZUARI: Jo, vetëm atë që ku kam lind edhe këtë belge, s’kam tjetër nënshtetësi.

GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z. Shala. Mund të uleni.

Tani do të kaloj në historikun procedural të çështjes.

Më 12 qershor 2020, në cilësinë e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, konfirmova aktakuzën e paraqitur nga Prokurori i Specializuar kundër të akuzuarit, në të cilën ai akuzohet për krimet e luftës në vijim: pika 1, ndalim arbitrar; pika 2, trajtim mizor; pika 3, torturë; dhe pika 4, vrasje e paligjshme.

Më 16 mars 2021, autoritetet belge arrestuan të akuzuarin në Belgjikë, kurse -- në atë moment iu dorëzuar edhe Aktakuza e Konfirmuar. Pas arrestimit, z. Shala zyrtarisht paraqiti apel, në përputhje me nenin 86(1) të ligjit belg për bashkëpunim. Ky apel u refuzua nga Gjykata e Apelit në Liezh më 6 prill 2021. Z. Shala u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë më 15 prill 2021.

Z. Shala, përpara se të vazhdojmë, dua të sigurohem se mund ta përcillni procedurën në gjuhë që e kuptoni dhe e flisni. A mund të më konfirmoni se e kuptoni dhe e flisni shqipen?

I AKUZUARI: Po.

GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z. Shala.

Me këtë konfirmim jam i bindur se mund t'i përcillni procedurat shqip si gjuhë që e kuptoni dhe e flisni, në përputhje me rregullën 92 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave.

Në qoftë se në çfarëdo momenti gjatë kësaj seance nuk keni përkthim, ose nuk e kuptoni ndonjë fjalë, atëherë ju lutem të ma bëni me dije menjëherë.

I AKUZUARI: Okei. Ju Faleminderit.

GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z. Shala.

Më lejoni tani të shpjegoj qëllimin konkret të paraqitjes së parë për nevojat e të akuzuarit dhe atyre që ndjekin seancën nga galeria e publikut dhe nëpërmjet transmetimit në internet.

Seanca e sotme nuk është gjykim. Në këtë seancë nuk do të paraqiten dhe as debatohen prova, dhe nuk do të diskutohet fajësia apo pafajësia e të akuzuarit e as nuk do të merret vendim në lidhje me të. Qëllimi i paraqitjes së parë përcaktohet në nenin 39 të Ligjit dhe rregullën 92 të Rregullores.

Në pajtim me këto dispozita, unë si Gjykatës i Procedurës Paraprake ia lexoj të akuzuarit akuzat e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar në një gjuhë që ai e kupton dhe flet; konfirmoj nëse i akuzuari e kupton aktakuzën; bindem se të drejtat e të akuzuarit, dhe veçanërisht e drejta e tij për të pasur avokat mbrojtës, janë respektuar; informoj të akuzuarin se brenda 30 ditësh nga dita e seancës së sotme, ai do të ftohet të vetëdeklarohet fajtor ose i pafajshëm në lidhje me secilën pikë të paraqitur në aktakuzë - në qoftë se i akuzuari dëshiron, ai mund të vetëdeklarohet menjëherë në lidhje me fajësinë ose pafajësinë; dhe në fund, caktoj data të tjera nëse është e nevojshme në kryerjen e detyrave të mia si Gjykatës i procedurës paraprake.

Pres nga palët që t’u përmbahen këtyre pikave të cilat unë do t’i trajtoj një nga një. Nëse palët dëshirojnë të diskutojnë ndonjë pikë tjetër që nuk është paraparë konkretisht në kuadër të seancës së sotme, palët ftohen që këtë ta bëjnë me anë të

parashtrimeve me shkrim.

Së pari, z. Shala, a mund të më konfirmoni se e keni marrë Aktakuzën e Konfirmuar në gjuhën që e kuptoni dhe flisni?

I AKUZUARI: Po.

GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Shala.

Tani do t'i kërkoj sekretares së Gjykatës t'i lexojë akuzat e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar sikurse parashihet në nenin 39 të Ligjit dhe rregullën 92.

Urdhëroni zonja sekretare.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës.

Në Aktakuzën e Konfirmuar, Prokurori i Specializuar akuzon z. Pjetër Shala për:

Pika 1: Ndalim arbitrar, krim lufte i ndëshkueshëm në bazë të nenit 14(1)(c) të Ligjit, i kryer në ish-fabrikën e metalit në Kukës, Shqipëri, afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999;

Pika 2: Trajtim mizor, krim lufte i ndëshkueshëm në bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, i kryer në ish-fabrikën e metalit në Kukës, Shqipëri, afërsisht midis 17 majit dhe 5 qershorit 1999;

Pika 3: Torturë, si krim lufte i ndëshkueshëm në bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, i kryer në ish-fabrikën e metalit në Kukës, Shqipëri, afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999; dhe

Pika 4: Vrasje e paligjshme, si krim lufte i ndëshkueshëm në

bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, i kryer në ish-fabrikën e metalit në Kukës, Shqipëri, më 5 qershor 1999 ose rreth kësaj date.

Në lidhje me këto krime ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Shala mban përgjegjësi penale, në bazë të nenit 16(1)(a) të Ligjit, për:

kryerje fizike të krimeve të paraqitura në Pikat 1 deri në 3;

për kryerje si anëtar i një ndërmarrje kriminale të përbashkët të krimeve në Pikat 1 deri në 4, dhe, ndryshe, lidhur me Pikën 4, për kryerje si anëtar i ndërmarrjes kriminale të përbashkët të lartpërmendur të krimit të vrasjes së paligjshme, duke qenë i vetëdijshëm se një krim i tillë mund të kryhet gjatë realizimit të qëllimit të përbashkët të ndërmarrjes kriminale të përbashkët dhe duke e marrë përsipër këtë rrezik me vullnet të lirë; dhe

gjithashtu dhe si alternativë, për ndihmë dhe inkurajim të krimeve të paraqitura në Pikat 1 deri në 4.

Ju faleminderit.

GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit sekretare.

Z. Shala, dua t'ju kujtoj se ky nuk është momenti për t'i kundërshtuar akuzat, por thjesht për të konfirmuar se i kuptoni akuzat. Do të keni mundësi të bollshme për të kundërshtuar akuzat me ndihmën e avokatit mbrojtës.

Z. Shala, a i kuptuat akuzat e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar të cilat ua lexoi sekretarja e Gjykatës?

I AKUZUARI: Po, i nderuar, i kuptova, po qesharake më duken.

GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z. Shala.

Tani do t'ju informoj për të drejtat përpara kësaj Gjykate.

Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Rregullorja e Procedurës dhe e Provave ju garantojnë disa të drejta. Do t'ju lexoj këto më të rëndësishmet.

E para, prezumoheni i pafajshëm deri në vërtetimin e fajësisë suaj përtej dyshimit të arsyeshëm.

Në marrjen e vendimit mbi akuzat kundër jush, ju keni të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë në varësi të masave të urdhëruara për mbrojtjen e viktimave dhe të dëshmitarëve.

Keni të drejtën të informoheni në kohë dhe me hollësi me një gjuhë që e kuptoni lidhur me natyrën dhe arsyen e akuzave të ngritura kundër jush.

Keni të drejtën për të pasur kohë dhe mundësi të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes suaj, si edhe për të komunikuar me avokatët mbrojtës që ju vetë do t'i zgjidhni.

Keni të drejtën që të gjykoheni brenda një periudhe kohore të arsyeshme.

Keni të drejtën që të gjykoheni në praninë tuaj dhe të mbroheni nëpërmjet avokatëve tuaj mbrojtës.

Keni të drejtën që t'ju caktohet një avokat mbrojtës edhe atë pa pagesë në qoftë se nuk dispononi mjete të mjaftueshme financiare.

Keni të drejtë që t'u bëni pyetje, ose dikush tjetër t'u bëjë

pyetje dëshmitarëve në emrin tuaj, si edhe të kërkoni praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në emrin tuaj.

Keni të drejtën e ndihmës së një përkthyesi pa pagesë nëse nuk e kuptoni dhe flisni gjuhën që përdoret në Gjykatë.

Keni të drejtën që të mos detyroheni të dëshmoni kundër vetes apo që të pranoni fajësinë.

Keni të drejtën të qëndroni i heshtur. Nga kjo heshtje nuk do të nxirret asnjë përfundim negativ kundër jush.

Keni gjithashtu të drejtën të bëni deklarata pa betim në lidhje me çështjen. Keni dhe të drejtë të paraqiteni vetë si dëshmitar nën betim.

Keni të drejtë të paraqisni mocione paraprake për të kundërshtuar juridiksionin e Dhomave të Specializuara, për të pretenduar mangësi në formën e aktakuzës, si edhe për të kërkuar ndarjen e akuzave.

Keni të drejtë që brenda 30 ditëve nga dita e kësaj seance të merrni materialet mbështetëse të aktakuzës të parashtruara për konfirmim.

Keni të drejtën që t’ju jepen të gjitha deklaratat e dëshmitarëve që Prokuroria synon t’i thërrasë për të dhënë dëshmi gjatë gjykimit. Këto t’i merrni në gjuhën që e kuptoni dhe flisni; gjegjësisht, në gjuhën shqipe.

Keni të drejtë që t’ju jepet menjëherë informacion i cili në mënyrë të arsyeshme mund të sugjerojë pafajësinë tuaj, apo ta zbusë fajësinë tuaj, apo të ndikojë në kredibilitetin apo

besueshmërinë e provave të Prokurorit të Specializuar, sapo një informacion i tillë të jetë në ruajtjen, kontrollin apo dijeninë e Prokurorit.

Keni të drejtë që të gjitha materialet dhe provat përkatëse që ka Prokuroria t'ju vihen në dispozicion përpara ose gjatë procesit. Kjo e drejtë kushtëzohet vetëm nga kufizimet që janë rreptësisht të nevojshme dhe kur zbatohen masa mbrojtëse kompensuese.

Keni të drejtë që të mos mbaheni në paraburgim për periudhë të paarsyeshme kohore para hapjes së çështjes kundër jush.

Keni të drejtë të kërkoni rishqyrtimin e vendimeve mbi paraburgimin tuaj, si dhe të apeloni ato vendime drejtpërdrejt në Gjykatën e Apelit.

Keni të drejtë të apeloni drejtpërdrejt në Gjykatën e Apelit vendimet mbi mocionet paraprake për kundërshtimin e juridiksionit të Dhomave të Specializuara.

Keni të drejtë të kërkoni leje për apelimin e vendimeve të tjera.

Z. Shala, dëgjuat të drejtat më të rëndësishme që gëzoni në përputhje me kornizën ligjore në fuqi të Dhomave të Specializuara. A i keni të qarta këto të drejta z. Shala?

I AKUZUARI: Po, i nderuar, vetëm desha një pyetje. Unë disa herë kam ardh në tribunalin e Hagës, në 2004, në 2005, në 2007, edhe për EULEX-in në 2016. Nuk ka pas nevojë të bëhet kjo ndodhja, arrestimi, ky farë filmi. Vetëm një ftesë, unë vij e paraqitem

vetë. Ju faleminderit.

GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Shala. Ju kuptova shumë mirë.

Dua t'ju informoj se sipas nenit 24(5)[sipas përkthimit] të Ligjit nuk mund të përfaqësoheni vetë, duhet të përfaqësoheni përmes një avokati mbrojtës. E kam për detyrë, si Gjykatës i Procedurës Paraprake, të sigurohem se e drejta juaj për të pasur avokat respektohet.

Për këtë qëllim kam mbajtur shënim parashtrimin e protokolluar të Administratores, ku më informon për ngarkimin në detyrë të z. Gilissen. Gjithashtu kuptoj nga raporti i Administratores dhe nga parashtrimet e z. Gilissen sot, se ai ju përfaqëson jo vetëm për këtë seancë të parë por për të gjithë kohëzgjatjen e procesit në përputhje me pjesën 14 të Direktivës mbi avokatin mbrojtës.

Z. Gilissen, a mund të konfirmoni se është kështu dhe se jeni caktuar të përfaqësoni si avokat mbrojtës z. Shala për gjithë kohëzgjatjen e procesit?

Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, zoti Kryetar, po.

GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Gilissen. Atëherë, bindem se i akuzuari përfaqësohet me avokat mbrojtës këtu.

Tani do t'i kthehem mundësisë që i akuzuari të vetëdeklarohet i pafajshëm apo i fajshëm nëse dëshiron sot.

Z. Shala, keni afat 30 ditë duke filluar nga sot, brenda së

cilës do të ftoheni, do të thirreni pra, që të vetëdeklaroheni i fajshëm apo i pafajshëm lidhur me akuzat e ngritura në aktakuzë. Nëse dëshironi, këtë gjë mund ta bëni menjëherë që sot.

Atëherë, z. Shala po ju pyes, a keni pasur mundësi që t'i diskutoni akuzat e ngritura në Aktakuzën e Konfirmuar me avokatët tuaj, dhe a jeni i gatshëm që sot të vetëdeklaroheni? Nëse po, atëherë ju lutem të ngriheni më këmbë nëse dëshironi të vetëdeklaroheni.

I AKUZUARI: Ju faleminderit zoti Gjyqtar. Unë nuk e ndi veten që e kam bë ndonjë krim, përpos që kam mbrojt atdheun tim dhe popullin tim, dhe jam i pafajshëm plotësisht. Ju faleminderit.

GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. U mbajt shënim.

Tani kalojmë në gjuhën e kësaj procedure. Dëshiroj që palëve t'u -- të paraqesin parashtrimet e tyre lidhur me gjuhën e punës.

Nuk e di nëse palët dëshirojnë që të shprehen për këtë.

MS. IODICE: [Përkthim] Po, i nderuar zoti Gjykatës, gjuha e punës duhet të jetë gjuha angleze.

GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Gilissen.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, zoti Gjykatës, gjuha e punës duhet të jetë në anglisht, dhe, sigurisht, përkthimi në shqipe.

GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Gilissen. Do të jap vendim lidhur me këtë.

Unë do të parashikoj një konferencë mbi ecurinë e çështjes, në përputhje me rregullën 96, për t'u zhvilluar pas kësaj seance

1 të parë.

2 Qëllimi i konferencës mbi ecurinë e çështjes do të jetë që të
3 shqyrtohet ecuria e saj dhe të organizohen shkëmbimet e
4 materialeve midis palëve për të siguruar një përgatitje të
5 përshpejtuar për gjykim.

6 Z. Shala, dëshiroj t'ju rikujtoj se keni të drejtën që vetë
7 të jeni i pranishëm në konferencën mbi ecurinë e çështjen së
8 bashku me avokatët tuaj. Por me pëlqimin tuaj me shkrim dhe pasi
9 të jeni këshilluar me avokatët tuaj, në përputhje me rregullën
10 96(2), në konferencës mbi ecurinë e çështjes ju mund të merrni
11 pjesë vetë fizikisht në sallë, ndërkohë që avokati merr pjesë
12 përmes videokonferencës; nga avokati i pranishëm, dhe ju z. Shala
13 merreni pjesë në distancë me videokonferencë; por mund të
14 zhvillohet edhe në mungesën tuaj, ku avokati mund të jetë i
15 pranishëm në sallë ose të marrë pjesë përmes videokonferencës.

16 Dëshiroj që t'u rikujtoj të gjithë palëve lidhur me këtë që
17 nëse avokati apo i akuzuari dëshiron që të marrë pjesë përmes
18 videokonferencës, duhet që të jepet njoftim me shkrim 24 orë
19 përpara lidhur me këtë në mënyrë që Zyra Administrative e Gjykatës
20 të marrë masat për këtë. Një njoftim i tillë i dërgohet me imeil
21 Zyrës Administrative dhe duhet të përfshijë dhe pëlqimin me shkrim
22 që jep i akuzuari për këtë. Zyra Administrative i protokollon këto
23 imeile dhe këto letërkëmbime si procesverbal të procesit.

24 Dëshiroj që t'i kujtoj palët dhe t'i pyes nëse dita e premte,
25 23 prill, ora 11.00, a është datë e përshtatshme dhe orë e

1 përshtatshme si konferencë e parë mbi ecurinë e çështjes; dëshiroj
2 të pyes edhe avokatët nëse dëshirojnë të marrin pjesë, të jenë të
3 pranishëm në sallë apo të marrin pjesë përmes videokonferencës?
4 Në fillim i drejtohem Prokurorisë.
5 MS. IODICE: [Përkthim] Po, zoti Gjykatës. Po, jemi në
6 dispozicion ditën e premte, ora 11.00.
7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit zonja prokurore.
8 Z. Gilissen.
9 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, zoti Gjykatës. Të dy jemi në
10 dispozicion për ditën e premte.
11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] A do të merrni pjesë fizikisht
12 këtu në sallë apo përmes videokonferencës?
13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mendoj se personalisht në --
14 fizikisht në sallë.
15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. Atëherë do ta
16 parashikoj konferencën mbi ecurinë e çështjes për ditën e premte,
17 23 prill, në ora 11.00.
18 Do të merrni edhe urdhrin e përcaktimin e datës që përfshin
19 edhe rendin e ditës për këtë seancë. Do t'u lutem palëve që të
20 bëjnë parashtrime me shkrim lidhur me temat e konferencës mbi
21 ecurinë e çështjes dhe çdo çështje tjetër të cilën dëshirojnë që
22 ta ngrenë gjatë kësaj konference për ecurinë e çështjes.
23 Synoj që ditën e enjte, 22 prill, ora 12.00 e drekës ta
24 caktoj si datë për, pra, si datë -- si afat për këto parashtrime
25 me shkrim.

Sa i takon konferencës mbi ecurinë e çështjes, do të nxjerr një vendim mbi detyrimet që ka Prokurori i Specializuar për nxjerrjen e materialeve në përputhje me rregullën 102 dhe për regjimin e redaktimeve për këtë procedurë. Përpara se ta nxjerr këtë vendim, do të kërkoj parashtrime nga palët dhe rekomandoj që palët të shqyrtojnë vendimin -- vendimet e mia kornizë mbi nxjerrjen e materialeve për të gjitha lëndët e tjera përpara kësaj gjykate përpara se të bëjnë parashtrime me shkrim.

Tani, u lutem palëve nëse -- që të ngrenë çështje të tjera nëse dëshirojnë që të bëjnë kështu. I kujtoj palët që të më njoftojnë paraprakisht nëse ndonjë parashtrim kërkon nxjerrjen e informacioneve konfidenciale në mënyrë që të kalojmë në seancë private.

Zonja prokurore.

MS. IODICE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar zoti Gjykatës. Nuk kemi çështje për të ngritur sot.

GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Gilissen.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Zoti Gjykatës, nuk kemi hë për hë për të ngritur çështje.

GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Gilissen.

Dëshiroj që t'i lutem të akuzuarit -- të pyes të akuzuarin z. Shala, nëse keni ndonjë çështje për të ngritur lidhur me arrestimin, transferimin, apo paraburgimin tuaj?

I AKUZUARI: Jo, i nderuar. Siç ju thashë, më duket qesharak,

po nuk kam asgjë me shtu, janë avokatët për atë punë.

Faleminderit.

GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Shala.

Përpara se ta mbyllim seancën sot, dëshiroj që të jap këto urdhra gojarisht lidhur me riklasifikimin:

Duke mbajtur parasysh se i duhet kushtuar rëndësi të drejtës së të akuzuarit për një gjykim publik, si edhe duke pasur parasysh detyrimin për të mbrojtur viktimat dhe dëshmitarët, jap këto -- i jap urdhër Zyrës Administrative që të riklasifikojë dokumentin F00003, F00005 dhe F00012 si dokumente publike; dhe F00009 si dokument konfidencial.

Gjithashtu, i jap urdhër ZPS-së që të parashtrojë në mënyrë të protokolluar brenda datës 26 prill 2021 versionet konfidenciale të redaktuara dhe/ose version publik të redaktuar për dokumentet e mëposhtme në varësi të klasifikimeve të tyre apo nëse duhet ruajtur këto klasifikime: F00002, përfshirë dhe shtojcat 1 dhe 3; F00004, përfshirë dhe shtojcat 1 dhe 3; F00010, përfshirë shtojcën 2; F00011, përfshirë shtojcat; F00015, përfshirë shtojcat; dhe F00016.

Krahas kësaj, i jap urdhër Zyrës Administrative që të depozitojë brenda datës 26 prill 2021 versionet konfidenciale të redaktuara apo publike të redaktuara të parashtrimeve të mëposhtme, apo të tregojnë nëse duan që të riklasifikojnë si konfidenciale apo publike apo nëse duhet ruajtur klasifikimi aktual: F00013; F00014, përfshirë shtojcën; F00017, përshirë

shtojcën; F00018, përfshirë shtojcën; F00019, përfshirë shtojcat; dhe F00021, përfshirë shtojcat; dhe F00022.

Këtu mbyllet urdhri i dhënë nga ana ime gojarisht.

Në fund, dëshiroj t'i rikujtoj ZPS-së se ka dy javë afat, duke filluar nga kjo seancë e paraqitjes së parë, për të parashtruar kërkesën për masa mbrojtëse. Nëse ZPS-ja dëshiron që ta parashtrojë këtë kërkesë brenda këtij afati dyjavor, do të ishte dhe më mirë akoma. Faleminderit.

Z. Shala, ndërkohë që ju do të vijoni të qëndroni në paraburgim, dëshiroj t'ju informoj se mund ta kundërshtoni mbajtjen në paraburgim në përputhje me rregullën 57. Kjo do të bëhet në dokumentet e paraqitura me shkrim.

Këtu mbyllet seanca e sotme. Falënderoj palët dhe Zyrën Administrative për praninë. Si zakonisht, falënderoj përkthyesit, stenografët, teknikët audiovizivë dhe personelin e sigurisë për asistencën e tyre.

Këtu mbyllet seanca. Faleminderit.

--- Seanca e paraqitjes së parë përfundoi në orën 15.31